



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 509/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.509/2019 e datës 23.11.2019, e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 2510D/01R, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 23.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.509/2019 nga koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendohet se me datë 22.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit, në Vendvotimin me numër 2510D/01R është shpallur i vlefshëm 1 (një) fletëvotim, dhe sipas parashtruesit të ankesës, ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit për arsye se është votuar në dy hapësira të subjekteve politike “një shkrim i shkarravitur” i vendosur në rubrikën dhe hapësirën e subjektit politik me nr.126, po ashtu “një shkrim i shkarravitur” është vendosur edhe përkrah hapësirës së subjektit politik me nr.111. Si provë për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur shtojcën nr.8 (Mostër e fletëvotimit të pavlefshëm) dhe kopjen e fletëvotimit të ankimuar.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 23.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në rastin e vendvotimit 2510D/01R fletëvotimi është shpallur i vlefshëm për arsye se shihet qëllimi i qartë i votuesit tek subjekti 126, ndërsa tek subjekti 111 ka një vijë jashtë emrit të subjektit që në bazë të doracakut nuk e bënë fletëvotimin e pavlefshëm sepse nuk ka prekur shkrimin e asnjërit subjekt.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Koalicioni NISMA – AKR – PD, si palë ankuese, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në PZAP, ku ka kërkuar që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm pasi që është votuar në dy hapësira të subjekteve politike, në subjektin politik LVV dhe është vendosur një shenjë në hapësirën e subjektit politik PLE me numër rendor 111.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 2510D/01R duhet të shpallet i pavlefshëm pasi që është konstatuar se tek subjekti politik LVV janë evidentuar shenja të ç'rregullta brenda katrorit dhe në hapësirën e këtij subjekti, ndërsa hapësira e subjektit politik PLE është shënjuar me një shenjë.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se qëllimi i votuesit nuk ka qenë i qartë, kështu që Paneli ka shpallur të pavlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe i njëjti duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga pavlefshmëria e fletëvotimit si në dispozitiv të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni të bashkangjitur me këtë vendim, që duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 509/2019 më datën 24.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



Republika e Kosovës
 Republic of Kosovo
 Komiteti Qendror i Zgjedhjeve
 Centralna Izborna Komisija
 Central Election Commission



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019 PËRVREMENI IZBORI ZA SKUPŠTINË REPUBLIKE KOSOVO 2019

1

Shënjeni VETËM NJË subjekt politik
 Oznaçite SAMO JEDAN politički subjekat

25100/01R

2

Shënjeni MË SË SHUMTI PESË kandidat
 Oznaçite NAJVISË PET kandidata

111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE
112. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
113. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
115. PARTIJA KOSOVSkih SRBA - PKS
116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
117. POKRET ZA GORA - PG
118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
119. AAK- PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
120. SLOBODA
121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
122. NISMA SOCIALDEMOKRATE ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË
123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
124. KOALICIJA VAKAT
125. FJALA
126. LËVIZJA VETËVENDOSJEI
127. KOSOVA DEMOKRATIK TËRK PARTISI - KDTP
128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
132. ESMIR KASI
133. GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
135. SRPSKA LISTA

<input checked="" type="checkbox"/>	2	3	4
<input checked="" type="checkbox"/>	6	7	8
9	<input checked="" type="checkbox"/>	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	<input checked="" type="checkbox"/>	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
<input checked="" type="checkbox"/>	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		

